



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada-Government
Ministria e Puneve te Jashtme – Ministarstvo Inostranih
Poslova- Ministry of Foreign Affairs



Instituti Hungarez për Marrëdhënie Ndërkombëtare

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

INSTITUTIT HUNGAREZ PËR MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Instituti Hungarez për Marrëdhënie Ndërkombëtare (këtu e tutje referuar si "Palët");

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Hungarisë dhe Kosovës dhe duke qenë TË GATSHËM që të promovojnë një bashkëpunim më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve;

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është krijimi i kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Neni 2

Bashkëpunimi

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave në lidhje me programet e tyre përkatëse të studimit dhe hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve tjera akademike dhe trajnuese.

Palët mund të shqyrtojnë mundësitë e formave tjera të bashkëpunimit sipas fushës së objektivave të këtij memorandumi.

Neni 3

Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të promovojnë kontaktet dhe shkëmbimin e të trajnuarve, ekspertëve dhe hulumtuesve.

Palët do të inkurajojnë studimet dhe hulumtimet, si dhe shkëmbimin e informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i informatave

Palët do të shkëmbejnë informatat dhe pikëpamjet në lidhje me trendët dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushat e trajnimit dhe hulumtimit në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, drejtën ndërkombëtare, marrëdhëniet e jashtme ekonomike, shkencat politike dhe në fusha tjera relevante.

Neni 5

Projektet e ndërmarra bashkërisht

Palët do të vendosin, përmes kanaleve përkatëse diplomatike specifikat dhe logjistikën e çdo projekti të ndërmarrë bashkërisht. Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të arrihen protokolle që përcaktojnë kushtet dhe afatet e shkëmbimeve të propozuara.

Neni 6

Kushtet financiare

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe të trajnimit të përfaqësuesve të Palëve Nënshkruese, do të dakordohen ndërmjet Palëve Nënshkruese.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet e ndërlidhura me interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit do të mund të ndryshohen me pëlqim të ndërsjellë më shkrim të Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyj në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë të jetë valid për një periudhë tre vjeçare. Pas kësaj periudhe, ky memorandum do të mund të rinovohet automatikisht për periudhë të njëjta kohore, përveç nëse njëra nga Palët vendosë ta përfundojë atë përmes njoftimit me shkrim nëntëdhjetë (90) ditë para përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në projektet në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit e mëposhtëm, personat e autorizuar, kanë nënshkruar këtë Memorandum,

E REALIZUAR në Hungari me _____ të _____ 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze, që të dy kopjet janë njësoj autentike

**Për Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës**

**Për Institutin Hungarez për
Marrëdhënie Ndërkombëtare**